



# FRIED: QEVERIA E KOSOVËS PO E BËN BEOGRADIN TË DUKET SI PALË E DËMTUAR

FAQE 4-5



Ish-ndihmësi i Sekretarit amerikan të Shtetit, Daniel Fried, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se nuk e kupton pse Qeveria e Kosovës po përplasat me Shtetet e Bashkuara, duke shtuar se me

veprimet e veta ajo po e bën Qeverinë në Beograd të duket si palë e dëmtuar, diçka që ai nuk ka besuar se mund të ndodhte. Diplomati amerikan i ka bërë këto deklarata teksa ka komentuar

veprimet e fundit të Qeverisë së Kosovës, duke përfshirë mbylljen e strukturave paralele dhe të degëve të Postës së Serbisë në veri, dhe synimet për hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër


## KFOR-I: FORCAT E SHTUARA NË URËN E IBRIT, PJESË E NJË TRAJNIMI

F.3



## SHEFI I AKI-së DHE AI I CIA-s ZBULUAN PLLAKËN E MIRËNJOHJES NDAJ SHBA-së

F.7



## GJYQIN NUK KA KUSH T'IA BËJË GJYQIT

Lulëzim ETEMAJ



Në fillim ishte:  
Republikë, Kushtetutë,  
Ja me hatër, ja me luftë!  
Pastaj u mbushën burgjet plot burra e gra e djem e çika të Kosovës  
Liria po priste te dera, s'e kishte thënë kot Jusuf Gërvalla

Në mezokohë dajaku në dorë të udbashit shqiptar  
I thyente eshtrat tanë!

Njëres nga ato, që një javë para i kishte mbushur të tetëmbëdhjetat  
E nëpër rrugët dhe sheshet e Prishtinës brohoriti: Rroftë Kosova Republikë!  
Para se ta nxirmin natën buzë një përroi për pushkatim  
Udbashët ia dogjën trupin e njomë me cigare  
Se nuk po hiqte dorë prej lirisë e prej vetvetes!

Në televizion  
në aktin e parafundit të lirisë burra e gra  
Tregojnë të skuqur, me përtesë e ndrojtje  
Ndonjë nga eshtrat e tyre dhe plagët e shtatit  
Në aktin pa numër, me të vetmen dëshmitare - natën!

Ndërsa sot, përtej 40 vjet pas  
Në emër të fjalës së lirë, radha e fjalës i vjen edhe udbashit

Gjyqin nuk ka kush t'ia bëjë gjyqit!

3 shtator 2024

(Lulëzim Etemaj, ish-i burgosur politik, i nxitur nga rrëfimet e kolegëve në TV "Dukagjin", si dhe nga paraqitja e ish-udbashit Mehmet Loci, nëpërmjet vargjeve poetike, i ka përshkruar disa hollësi të torturave të cilat i kanë vuajtur si të rinj, vetëm pse kanë kërkuar Republikë për Kosovën)

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) / [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Zelensky thotë se inkursioni në Rusi ndihmon në “planet për këmbim”

KIEV, 4 SHTATOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë se qëllimi i inkursionit të befasishëm në rajonin jugor rus Kursk, nisur muajin e kaluar, është kapja e tokave dhe trupave ushtarake për këmbim, dhe që Kievi nuk ka nevojë për tokën e Rusisë. “Nuk na duhet territor rus”, ka thënë Zelensky për “NBC News”. “Operacioni ynë ka për qëllim rikthimin e integritetit territorial. Ne kapim trupa ushtarake ruse për t’i këmbyer me trupat ukrainase”, ka thënë ai. “Ne u themi atyre, shikoni, neve na duhen ushtarët tanë në këmbim me rusët. E njëjta logjikë është edhe për territoret. Nuk na duhet toka e tyre”. Prej nisjes së inkursionit në rajonin Kursk, në fillim të gushtit, Kievi

pretendon se ka fituar kontrollin e mbi 1 200 kilometrave të territorit rus. Në raportimet paraprake janë dhënë sinjale që Kievi synon që përmes këtij operacioni ta pozicionojë veten më mirë në rast të nisjes së bisedimeve për paqe. Ukrainasit dhe analistët kanë sugjeruar se përmes operacionit ushtarak është mëtuar t’u tregohet edhe rusëve për situatën e luftës së nisur prej Moskës. Inkursioni në Kursk përbën pushtimin e parë të huaj të territorit rus prej Luftës së Dytë Botërore. Kievi dhe disa aleatët të tij kanë argumentuar së fundmi që ofruesit perëndimorë të ndihmës ushtarake, artilerisë dhe armëve të tjera, duhet të heqin kufizime se si



mund t’i përdorin forcat ushtarake ukrainase ato armë, dhe që ta mundësojnë shfrytëzimin e tyre për sulme më thellë në Rusi. I pyetur nëse Ukraina do të tentojë të zaptojë më shumë territor rus, Zelensky ka thënë përgjatë intervistës se nuk mund të japë më shumë hollësi. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën “operacion special ushtarak” për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

## Agjencia e OKB-së për Motin paralajmëron “alarm të kuq” pas nxehtësisë rekorde



GJENEVE, 4 SHTATOR - Rritja e temperaturave duhet të nxisë “alarm të kuq” global, ka thënë Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Mot dhe Klimë të mërkurën, pas rekordeve të thyera sërish në gusht. Bota ka regjistruar sërish rekord në temperaturat mesatare të gushtit, për herë të dytë radhazi, kanë treguar të dhënat preliminare të një agjencie të Bashkimit Evropian për Klimën. Australia, Japonia dhe disa pjesë të Kinës dhe Norvegjisë kanë regjistruar gushtin më të nxehtë

ndonjëherë në histori, sipas agjencie meteorologjike. “Është e qartë se temperaturat po rriten përtej asaj që do të dëshironim”, ka thënë Celeste Saulo, udhëheqëse e Organizatës Botërore të Meteorologjisë. “Kjo po ndodh sepse veprimi ynë nuk është i mjaftueshëm”. Ndonëse temperatura e saktë mesatare globale për këtë gusht nuk dihet, Shërbimi i BE-së për Motin ka thënë se shifra do të jetë mbi rekordin e vitit të kaluar – 16.82 gradë celsius.

Saulo ka bërë thirrje për monitorim më të mirë dhe mbështetje të agjencive për motin, meqë beson se “duhen më shumë burime”. Teksa ka marrë pjesë në një forum, ajo ka bërë me dije se Singapori do të jetë qendër rajonale për monitorim të ndotjes së shkaktuar nga zjarret e tokave të punuara dhe tymit. Duke qenë vetëm një prej dy qendrave të tilla në botë, kjo qendër do të ofrojë informacion më kualitativ për zjarret dhe parashikimet për ndotje.

## Vulini takon Putinin në Rusi

MOSKË, 4 SHTATOR - Presidenti rus Vladimir Putin është takuar të mërkurën me zëvendëskryeministrin e Serbisë, Aleksandar Vulin, në margjina të një forumi ekonomik në Vladivostok. Në takim, i cili është transmetuar drejtpërdrejt në platformën YouTube, Vulin ka thënë se Serbia nuk është vetëm partnere strategjike, por edhe aleate e Rusisë. Ai ka thënë se për shkak të qëndrimit të vet, Serbia është në presion të jashtëzakonshëm. “Mirëpo, Serbia, e udhëhequr prej presidentit serb Aleksandar Vuçiq, është Serbi që nuk do të bëhet kurrë anëtare e paktit të NATO-s, që nuk do të vendosë kurrë sanksione ndaj Rusisë dhe nuk do të lejojë kurrë që veprime anti-ruse të kryhen prej territorit të saj”, ka thënë Vulin.

Departamenti amerikan i Shtetit ka thënë më parë për Zërin e Amerikës se qëndrimi amerikan ndaj Vulinit “dihet mirë” dhe që ai është në sanksione amerikane. Paraprakisht, Bashkimi Evropian u ka thënë medieve në Serbi se “mbajtja e lidhjeve me Rusinë në kohën e agresionit kundër Ukrainës nuk është në përputhje me vlerat e BE-së dhe procesin e anëtarësimit”. “BE-ja ka qenë krejtësisht e qartë me partnerët tanë: marrëdhëniet me Rusinë nuk mund të jenë normale pas luftës së paprovokuar dhe të paarsyetuar të Rusisë kundër Ukrainës”, ka thënë blloku evropian në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë. Forumi në Vladivostok të Rusisë do të mbahet prej 3 deri më 6 shtator. Kryeministri i Serbisë, Millosh

Vuçeviq, ka thënë se vizita e Vulinit në Rusi nuk përbën “asgjë aq të tmerrshme”. “Ne nuk kemi shkëputur marrëdhëniet diplomatike me Federatën Ruse, nuk është e ndaluar për askënd që të takohet me përfaqësuesit e Federatës Ruse”, ka thënë ai për Radion Evropa e Lirë. Vuçeviq ka thënë se Serbia nuk e inkurajon luftën në Ukrainë dhe nuk e mbështet shkeljen e integritetit territorial të Ukrainës. Ai ka rikujtuar që edhe kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, si kryeministër i një vendi anëtar të Bashkimit Evropian dhe NATO-s, ka qenë së fundmi në Moskë dhe është takuar me Putinin. “Nëse Orbanit i lejohet, natyrisht që edhe Vulini mund ta takojë. Nuk shoh ku është ndryshimi apo qasja ndryshe”, ka thënë kryeministri i Serbisë.



Vulin ka qenë disa herë në Moskë prej nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë. Ai është i njohur për lidhjet e tij me Rusinë, ndërsa prej 11 korrikut të vitit të kaluar është futur në listën e zezë amerikane

për “korrupsion dhe veprime destabilizuese” me qëllim të avancimit të agjendave dhe interesave të tij personale, duke i bërë dëm pages dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor.



# Policia thotë se do t'i nxjerrë të gjitha materialet nga institucionet e mbyllura paralele

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, ka konfirmuar të mërkurën për "Radion Evropa e Lirë" se autoritetet e rendit do të nxjerrin gjatë ditës të gjitha materialet nga objektet e institucioneve paralele serbe në veri, të mbyllura më 30 gusht. Punonjësit do të mund t'i marrin gjërat private nëse ato nuk janë prova të nevojshme për policinë, ka thënë Elshani. Pas këtij aksioni këto ndërtesa do t'u kthehen pronarëve. Me ligjet e Kosovës pronare janë komunat: në Mitrovicë të Veriut, Komuna e Mitrovicës së Veriut, në Zveçan - Komuna e Zveçanit, e kështu me radhë.

Autoritetet e Kosovës kanë mbyllur më 30 gusht pesë institucione paralele në veri të cilat kanë funksionuar sipas sistemit të Serbisë. Sipas zyrtarëve shtetërorë në Kosovë, ato institucione kanë shkelur kushtetutshmërinë dhe ligjet e Republikës së Kosovës".

Institucionet e mbyllura më 30 gusht ishin: Qarku i Mitrovicës së Kosovës, Komuna paralele e Mitrovicës, Komuna paralele e Zveçanit, Komuna paralele e Zubin Potokut dhe Komuna paralele e Leposaviqit. Në disa nga objektet që më



herët janë përdorur nga institucionet paralele, ditët e fundit janë vendosur pllaka që tregojnë se tani ato do të përdoren si zyra për disa nga ministritë e Kosovës dhe departamentet e tyre. Punëtorët e atyre institucioneve paralele kanë protestuar dy ditë kundër mbylljes së tyre.

Policia e Kosovës ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se po të mërkurën do të intervistohen pesë persona të lidhur me këto institucione paralele. Policia nuk ka bërë me dije se për kë saktësisht bëhet fjalë, mirëpo REL ka mësuar se bëhet fjalë për zyrtarë të lartë të Listës Serbe - partisë më të madhe të

serbëve në Kosovë - të cilët kanë qenë në krye të organeve paralele serbe. Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, njëherësh negociator kryesor në dialog, ka thënë përmes një postimi në X se "Kurti vazhdon të bëjë terror". Përfundimi i ka kritikuar

Kosovën për ato që i ka konsideruar si veprime të njëanshme. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" ditë më parë se veprimet për shtrirje të sovranitetit janë legjitime, por që suksesi varet nga bashkëpunimi me aleatët.

## KFOR-i: Forcat e shtuara në urën e Ibrit, pjesë e një trajnimi



PRISHTINË, 4 SHTATOR - Forcat dhe mjetet e shtuara të misionit paqeruajtës të NATO-s, KFOR, të cilat u vunë re edhe të mërkurën në urën e Ibrit në Mitrovicë, janë të përkohshme dhe pjesë e një trajnimi periodik, konfirmoi KFOR-i për Radion Evropa e Lirë. Në deklaratën me shkrim misioni tha se trajnimi po kryhet "për t'i testuar procedurat dhe për t'i ruajtur standardet më të larta operacionale". Pa dhënë më shumë hollësi rreth tij, KFOR-i tha se "po e monitoron situatën e sigurisë në veri të Kosovës" dhe se "mbetet vigjilent".

Ky mision ka prani të përhershme në urën e Ibrit, që ndan Mitrovicën në jugun e banuar me shqiptarë dhe veriun e banuar me serbë. Forca të shtuara ka pasur edhe në fundjavën e kaluar, kur misioni ka konfirmuar po ashtu se ka kryer disa trajnime. Këto zhvillime vijnë pak ditë pasi autoritetet e Kosovës kanë mbyllur pesë institucione paralele serbe në veri. Banorët serbë të zonës prej vitesh kanë marrë shërbime të ndryshme në to dhe mbyllja e tyre ka shkaktuar reagim të ashpër të bashkësisë ndërkombëtare

kundër Kosovës. Përkundër faktit se për shuarjen e këtyre strukturave, ka një marrëveshje që është arritur në Bruksel qysh në vitin 2013, por zbatimi i saj ka ngecur. Bashkësia ndërkombëtare, megjithatë, kërkon që të gjitha çështjet që lidhen me situatën në veri të trajtohen në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ngjashëm ka kërkuar të trajtohet edhe çështja e hapjes së urës së Ibrit për qarkullimin e makinave, të cilën Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar se do ta bëjë.

## Mbahet punëtorja për finalizimin e projektligjeve për reformën në drejtësi

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Ministria e Drejtësisë, me mbështetje të OSBE-së, ka organizuar një punëtori treditore me qëllim të finalizimit të akteve normative të cilat rrjedhin nga Deklarata e Përbashkët e Zotimeve. Gjatë kësaj punëtorie, përveç ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, punëtorja u përbë edhe nga pjesëmarrësit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Akademia e Drejtësisë, përfaqësues të BE-

së, Ambasadës Amerikane, OSBE-së dhe OJQ-ve, me ç'rast po diskutohet më shumë rreth finalizimit të akteve normative që përfshijnë disiplinën, integritetin, performancën dhe statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në fjalën e saj, ministrja Haxhiu tha se me këto akte normative finalizohet procesi që rrjedhë nga Deklarata e Zotimeve, pjesë e reformës në drejtësi, përmes të cilave rregullohet kontrolli i

integritetit për gjyqtarët dhe prokurorët, forcohet sistemi i disiplinimit, vlerësimi i performancës dhe deklarimi i pasurisë. Po ashtu, janë përfshirë ndryshime të rëndësishme në ligjet që rregullojnë rekrutimin, avancimin dhe statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Aktet normative të finalizuara do të procedohen për votim në qeveri dhe Kuvendin e Kosovës në javët në vijim.







## Edhe nëse ka dialog, nuk ka pritje për rezultat

**“Është naive të presësh, sidomos në rastin e Kosovës, që mund të ketë ndonjë lëvizje në kohën kur Kosova është para zgjedhjeve të rregullta parlamentare. Mbase edhe mund të ndodhë takimi, por rezultati i takimit ka për të qenë zero”, thotë analisti Arton Demhasaj**

**PRISHTINË, 4 SHTATOR** - Këmbëngulja e Bashkimit Evropian mund të çojë në një raund të ri të bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, por analistët e çështjeve politike, Arton Demhasaj dhe Dushan Janjiq, dyshojnë se ai do të sillte ndonjë rezultat pozitiv. Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian në dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, la të kuptohet se këtë javë mund ta vizitojë Prishtinën për, siç tha, përgatitjen e raundit të ri të bisedimeve në nivel kryenegociatorësh. “Radio Evropa e Lirë” pyeti Qeverinë e Kosovës rreth këtij paralajmërimi dhe marrjes së ndonjë ftese nga BE-ja për ndonjë takim eventual, por deri në publikimin e këtij artikulli ajo nuk u përgjigj. Kryenegociatorët e Kosovës dhe Serbisë, Besnik Bislimi dhe Petar Petkoviç, u takuan për herë të fundit në fillim të korrikut, por pa ndonjë rezultat. Demhasaj, nga organizata joqeveritare “Çohu” në Prishtinë, thotë se insistimi i BE-së për një

raund të ri të dialogut Kosovë - Serbi do të jetë i pafrytshëm, derisa palët ta shmangin zbatimin e Marrëveshjes drejt normalizimit të marrëdhënieve. E njohur si Marrëveshja e Ohrit, ajo është arritur para më shumë se një viti, por asnjë pikë e saj nuk është zbatuar dhe për këtë palët fajësojnë vazhdimisht njëra-tjetrën. Për më tepër, shton Demhasaj, Kosova ka caktuar 9 shkurtin e vitit të ardhshëm si datë për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta parlamentare dhe, sipas tij, vendi është tashmë në para-fushatë zgjedhore. “Është naive të presësh - sidomos në rastin e Kosovës - që mund të ketë ndonjë lëvizje, në kohën kur Kosova është para zgjedhjeve të rregullta parlamentare. Bashkimi Evropian mund të insistojë që të ketë takim. Mbase edhe mund të ndodhë takimi, por rezultati i takimit ka për të qenë zero”, thotë ai për “Radion Evropa e Lirë”. Demhasaj një pjesë të përgjegjësisë e hedh edhe te Bashkimi Evropian si ndërmjetësues i dialogut. Sipas tij, BE-ja duhet ta ndryshojë qasjen në këtë proces. “Derisa

nuk e ndryshon - pra të caktojë afate kohore për palët që t’i kryejnë obligimet që i marrin nga marrëveshjet që i arrijnë, të marrë masa ndëshkuese ndaj palës që nuk i kryen obligimet - mendoj se kështu kemi për të vazhduar ndoshta edhe me vite”, thotë Demhasaj. Qëndrim të ngjashëm ka edhe Janjiq nga Forumi për Marrëdhënie Etnike në Beograd. Ai thotë se BE-ja, në këtë fazë, mund t’ia dalë t’i ulë bashkë Bislimin e Petkoviçin, por jo udhëheqësit politikë - kryeministrin e Kosovës, Albin Kurtin, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Dy të fundit janë takuar për herë të fundit në shtator të vitit 2023. Një përpjekje e mëvonshme për takim ka dështuar, për shkak të, siç është thënë, disa kushteve që ka nxjerrë Kurti atëkohë, e që Vuçiqi nuk i ka pranuar. Por, Janjiq thotë se as në rastin e takimit të kryenegociatorëve, ai nuk pret ndonjë rezultat pozitiv. “Nuk besoj. Çfarë mund të merren vesh ata? A mund ta thotë haptas [zëdhënësi i BE-së, Peter] Stano se dinë se institucionet paralele janë jolegale? Nuk mundet, sepse kanë marrë pjesë në atë turbullim të opinionit, por edhe të Vuçiqit, se do të ketë Asociacion të Komunave me Shumicë Serbe. Pse nuk u bisedua për arsimin? Nuk është temë fare. Ata dëshirojnë tash të flasin për objektet e zaptuara dhe për atë se a do ta kalojë dikush urën?”, thotë Janjiq për “Radion Evropa e Lirë”.

Nga fundi i javës së kaluar çështja e institucioneve paralele serbe në Kosovë është aktualizuar sërish, pasi autoritetet e Kosovës kanë mbyllur pesë të tilla në pjesën veriore të vendit. Banorët serbë të zonës prej vitesh kanë marrë shërbime të ndryshme në to dhe mbyllja e tyre ka shkaktuar reagim të ashpër të bashkësisë ndërkombëtare kundër Kosovës. Kjo, përkundër faktit se për shuarjen e këtyre strukturave ka një marrëveshje që është arritur në Bruksel qysh në vitin 2013, por zbatimi i saj ka ngecur. Bashkësia ndërkombëtare, megjithatë, kërkon që të gjitha çështjet që lidhen me situatën në veri të trajtohen në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Ngjashëm ka kërkuar të trajtohet edhe çështja e hapjes së urës së Ibrit për qarkullimin e makinave, gjë të cilën Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar se do ta bëjë. Janjiq thotë, po ashtu, se qasja e Bashkimit Evropian në ndërmjetësimin e dialogut Kosovë - Serbi është krejtësisht burokratike dhe pa “shkop ose karotë”, përkatësisht pa dënim e shpërblym. Sipas tij, BE-ja, por edhe vendet e Quint-it - ShBA-ja, Gjermania, Franca, Italia dhe Britania e Madhe - duhet ta mbështesin esencën e dialogut, duke zgjidhur çështjet më të rëndësishme, të cilat do të çonin natyrshëm drejt normalizimit të qëndrueshëm të raporteve. “E këto [çështje] janë: suksesioni - pra, çfarë do të

ndodhë me pronën, zgjidhja e statusit të serbëve si pjesë e statusit të Kosovës, si dhe pjesa e tretë që ka të bëjë me gjërat fundamentale, pra, ekonomia, përfitimet etj. Siguria duhet të vijë në mënyrë të natyrshme përmes komunikimit NATO - Kosovë dhe NATO - Serbi”, thotë Janjiq. Bashkimi Evropian gjatë gjithë kohës këmbëngul se të gjitha marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, i cili ka nisur qysh në vitin 2011, duhet të zbatohen. Marrëveshje të tilla janë me dhjetëra, por shumë pak janë zbatuar. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha në një forum të sigurisë në fundjavë, se Kosova nuk ka trajtim të barabartë në dialogun me Serbinë. “REL”-i kërkoi koment për këto pretendime nga zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, por nuk mori. E BE-ja thotë se rruga e Kosovës dhe Serbisë drejt integritimit evropian varet nga normalizimi i marrëdhënieve. Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE në fund të vitit 2022, por nuk ka marrë përgjigje. Serbia i ka nisur negociatat për anëtarësim në bllok në fillim të vitit 2014, por grupin e fundit të kapitujve e ka hapur në dhjetor të vitit 2021. Ngecja e Serbisë në proces ka ndodhur kryesisht për shkak të mospërputhjes me politikën e jashtme të BE-së, e sidomos për shkak të mosvendosjes së sanksioneve kundër Rusisë pas pushtimit të Ukrainës.



# Fried: Qeveria e Kosovës po e bën Beogradin të duket si palë e dëmtuar



PRISHTINË, 4 SHTATOR - Ish-ndihmësi i Sekretarit amerikan të Shtetit, Daniel Fried, i ka thënë “Radios Evropa e Lirë” se nuk e kupton pse Qeveria e Kosovës po përplaslet me Shtetet e Bashkuara, duke shtuar se me veprimet e veta ajo po e bën Qeverinë në Beograd të duket si palë e dëmtuar, diçka që ai nuk ka besuar se mund të ndodhte. Diplomati amerikan i ka bërë këto deklarata teksa ka komentuar veprimet e fundit të Qeverisë së Kosovës, duke përfshirë mbylljen e strukturave paralele dhe të degëve të Postës së Serbisë në veri, dhe synimet për hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër. Sipas tij, nuk është në interesin e askujt që Kosova të ketë mosmarrëveshje me miqtë e vet.

Në intervistën e realizuar në margjina të forumit të sigurisë, Globsec, të mbajtur në Pragë, Fried ka folur edhe për ndikimin rus në Ballkanin Perëndimor dhe për qasjen e ShBA-së ndaj

rajonit, varësisht kush fiton zgjedhjet presidenciale amerikane në nëntor.

Në pyetjen se Kosova është kritikuar së fundmi nga Perëndimi për hapa të njëanshëm, rreth tentimeve për hapjen e urës mbi lumin Ibër për automjete, për mbylljen e institucioneve paralele, për mbylljen e Bankës së Serbisë në veri të Kosovës. Si i shihni hapat e qeverisë?, Fried është përgjigjur: “I shoh me shumë vështirësi. Pra, nuk e kuptoj pse Qeveria e Kosovës po përplaslet me Shtetet e Bashkuara. Qeveria e Kosovës ka arritur disi ta bëjë qeverinë serbe në Beograd të duket si palë e dëmtuar. Nuk e kam menduar që kjo do të ishte e mundshme, por ajo e ka bërë. Kjo do të thotë se Shtetet e Bashkuara po shpërfillen dhe përplasja me miqtë e Kosovës nuk është në interesin e askujt. Kosovarët nuk kanë nevojë që një amerikan t’ju tregojë që disa njerëz brenda administratës [së

ish-presidentit amerikan, Donald] Trump kanë simpati të madhe për Serbinë. Nëse Trumpi fiton, ajo simpati mund të rikthehet. Nuk shoh asnjë arsye për t’i justifikuar politikat e njerëzve që do të vendosnin presion ndaj Kosovës, pa asnjë arsye, dhe ta mbanin komod Serbinë, kur nuk është në interesin e askujt. Prandaj, veprimet e Qeverisë së Kosovës janë enigmë për mua. Kam lexuar deklarata të Ambasadës Amerikane dhe zemërimi vërehet qartë. Sërish nuk shoh interes. Nuk është se kam simpati të madhe për separatistët serbë në veri, apo për njerëzit që e kanë bërë urën çështje të nxehtë. E kuptoj zemërimin. Por, ekzistojnë mënyra si të trajtohet dhe si të mos trajtohet kjo temë. E kam në mendje flamurin e Kosovës. Ai flamur është dizajnuar për t’u dukur si flamuri i Bashkimit Evropian. Yjet në flamur përfaqësojnë popullsinë e

Kosovës. Ai nuk është flamur amerikan. Është kosovar. Është flamur i mrekullueshëm, i cili tregon se Kosova nuk është krijesë e nacionalizimit etnik, por është vend i të gjithë atyre që jetojnë në të. Kjo është pikëpamja amerikane dhe e Bashkimit Evropian. Prandaj, nuk e kuptoj atë që po bën Qeveria e Kosovës”. Ai ka thënë se Serbia dëshiron të mbajë një këmbë në Evropë, një këmbë në Rusi, pak lëvizje drejt Kinës. “Kjo është lojë e njohur, dhe më duket ide më e mirë që Kosova të mos luajë lojë të ngjashme, por të punojë me Bashkimin Evropian për ta forcuar pozicionin e vet. Po, dialogu mund të ketë vështirësi, mirëpo nëse problemi, sipas Kosovës, qëndron te mosgatishmëria e Serbisë për të pranuar që Kosovën e ka humbur përmes veprimeve të veta, me fajin e vet, atëherë Kosova duhet të bëjë gjithçka që mundet për ta bërë të qartë se e

ardhmja e vet është me Evropën, dhe shpresoj që një ditë edhe në Bashkimin Evropian, ashtu sikurse Serbia, çka ndihmon në minimizim të këtyre problemeve”, ka deklaruar Fried.

Ish-ndihmësi i Sekretarit amerikan të Shtetit mendon se veprimet e Kosovës po e vështirësojnë nisjen e një bisede të sinqertë me Beogradin që do të duhej të ndodhte. “Më duket se është në interesin e secilit t’i ndihmojë qeverisë serbe të kuptojë se ka nevojë ta rikalibrojë qasjen e vet, mirëpo edhe kjo po vështirësohet kur të gjithë janë të zemëruar me Qeverinë e Kosovës. Është me rëndësi të them se është e dhimbshme, sepse ne kemi pasur një marrëveshje me Kosovën kur kemi punuar drejt pavarësisë, që kosovarët kanë thënë se do të jetojnë ‘në përputhje me vlerat e Evropës dhe Shteteve të Bashkuara që na kanë shpëtuar’”, ka thënë Fried.



## Tërnavë i jep mirënjohje Halil Kastratit

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur të mërkurën në takim drejtorin e shoqatës “Jetimat e Ballkanit”, Halil Kastrati. Gjatë këtij takimi u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të

Kosovës dhe Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”, për çka të dyja palët shprehën gatishmërinë e tyre në shërbim të qytetarëve të vendit. Myftiu Tërnavë vlerësoi lart punën dhe angazhimin e Shoqatës “Jetimat e Ballkanit” në ndihmë të varfërve dhe nevojtarëve.

Me këtë rast, myftiu Tërnavë ndau një mirënjohje për drejtorin e Shoqatës, Halil Kastrati, për kontributin e tij të veçantë humanitar në mbështetje të njerëzve nevojtarë në Kosovë dhe në hapësirën shqiptare, duke u bërë simbol frymëzues i solidaritetit njerëzor, kombëtar dhe fetar.



## AGK-ja e nderon me mirënjohje shefin e OSBE-së për përkushtimin ndaj lirisë së medias



PRISHTINË, 4 SHTATOR - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka pritur në takim lamtumirës shefin e OSBE-së, Michael Davenport. Kryetari i AGK-së, Xhemajl Rexha, së bashku me drejtoreshën ekzekutive, Getoarë Mulliqi, falënderuan ambasadorin Davenport për bashkëpunimin dhe mbështetjen e pakursyer dhënë AGK-së dhe komunitetit të gazetarëve. Njëherësh theksuan rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit ndërmjet organizatave për avokimin e sigurisë së gazetarëve, fuqizimin e lirisë së medieve në

Kosovë si dhe ngritjen e kapaciteteve të gazetarëve të të gjitha komuniteteve. Gjatë takimit AGK-ja i ka dhënë ambasadorit Davenport një mirënjohje si falënderim për përkushtimin personal për lirinë e medias në Kosovë. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës është mirënjohës për partneritetin e mirë që e gëzon me OSBE-në, që prej themelimit të organizatës në vitin 2002. OSBE ndër vite ka mbështetur aktivitete dhe trajnime të shumta të AGK-së, duke luajtur rol krucial në kthimin e Çmimeve Vjetore në Gazetari në vitin 2021.

## Mbahet takimi ndërinstytucional për trajtimin dhe parandalimin e rasteve të dhunës në familje



PRISHTINË, 4 SHTATOR - Në kuadër të aktiviteteve për parandalimin e rasteve të dhunës në familje, rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për raportimin e rasteve të dhunës në familje, Divizioni i Policimit në Bashkësi - Drejtoria e Dhunës në Familje, në bashkëpunim me DRP Mitrovicë Veri dhe përkrahje të KK Mitrovicë Veri,

ka mbajtur takim me zyrtarë komunalë, Qendrën për Punë Sociale, përfaqësues nga OSBE-ja dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme joqeveritare. Qëllimi i takimit ishte bashkëpunimi ndërmjet institucioneve me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit në trajtimin e rasteve të dhunës në

familje, zhvillimin e kampanjave për vetëdijësimin e qytetarëve për raportimin e rasteve të dhunës në familje si dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për ofrimin e shërbimeve për viktimat si dhe të drejtat ligjore për shërbimet pa pagesë që u takojnë viktimave të dhunës në familje.

## Latifi nderon dëshmorët dhe martirët në Dejnë dhe Dobidol

RAHOVEC, 4 SHTATOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nderuar dëshmorët dhe martirët në Dejnë dhe Dobidol. “Në Dobidol u përulëm me respekt të lartë para lapidarit të bashkëluftëtarit, dëshmorit të kombit Mark Sopjani, i cili ra më 4 shtator 1998. Në Dejnë kujtuam me nderim dëshmorin Arben Bytyçi, i rënë po më 4 shtator 1998. Kanë kaluar 26 vjet nga tragjedia në vendin e quajtur Liskoç, mbi fshatin Dejnë, ku predhat e artillerisë serbe morën jetë e Leonora Bytyçi dhe të vëllait të saj, dëshmorit Arben Bytyçi”, ka thënë Latifi, duke shtuar se aty u vranë edhe Minkadise Bytyçi, Sevdije Hoti, Elmaze Bytyçi, Shpresa Bytyçi, Bahrije Bytyçi dhe fëmija 15-muajsh Driton



Hoti. “Në Liskoç mbetën të plagosur edhe 56 të tjerë. Dejni i ka dhënë luftës për liri dëshmorët: Arben Bytyçi, Bekim Bytyçi, Ramiz Krasniqi, Milaim Morina, Xhevdet Krasniqi dhe Qemajl Bytyçi, si dhe martirët Gani Morina dhe Muhamet Hoti. Sot dhe përherë përulemi me përkushtim të thellë për veprën e dëshmorëve dhe të gjithë të rënëve për liri”, ka theksuar kryetari Latifi.

## Nënkryetari i Mitrovicës viziton Shkollën Fillore “Migjeni”

MITROVICË, 4 SHTATOR - Me rastin e fillimit të vitit shkollor, nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, së bashku me kryesuesen e Kuvendit të Komunës, Vesa Broja, drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, Drita Kadriu dhe

asamblisten e KK-së, Majlinda Kurti, kanë vizituar Shkollën Fillore “Migjeni”. Nënkryetari Tahiri para nxënësve potencoi se është ditë gëzimi për të gjithë fëmijët që u hapën dyert e shkollave dhe u kthehen

bankave, shoqërisë, mësimëve e lojërave të tyre. “Jam i lumtur ta shoh entuziazmin e nxënësve dhe përkushtimin e mësimdhënësve për një vit të suksesshëm shkollor”, është shprehur nënkryetari Tahiri.





## Kurti paraqitet nga ballkoni i qeverisë: Po punojmë që FSK-ja të jetë sa më e fortë

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti ka pritur të mërkurën në takim komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci dhe ministrin e Financave, Punës dhe Trasfereve, Hekuran Murati, me të cilët ka diskutuar për

fuqizimin e FSK-së. “Në Ballkonin e Hapur flasim hapur: një mëngjes pune në kryeministri me Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci dhe ministrin e Financave, Punës dhe Trasfereve, Hekuran Murati. Diskutuaam planet dhe

mbështetjen e Qeverisë që asnjëherë nuk ka qenë më e madhe e më e lartë. Zhvillimi dhe fuqizimi i ushtrisë në shërbim të mbrojtjes dhe sigurisë së vendit është ndër prioritet tona kryesore, andaj po punojmë çdo ditë që FSK-ja të jetë sa më moderne, sa më e fortë dhe po aq profesionale”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.



## Haradinaj: Ushtria s'do të duhej kurrë të ishte kazan i votave të Albin Kurtit



PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka reaguar ndaj deklaratës së kryeministrit Albin Kurti se është duke punuar që FSK-ja të jetë sa më e fortë. Haradinaj ka theksuar se gjithmonë është lajm i mirë kur kryeministri i vendit takon krerët e sigurisë, por kur pas katër vitesh qeverisje premtimet parazgjedhore mbesin mashtrime paszgjedhore, është e natyrshme që edhe ky takim është veç fillim i mashtrimit të radhës. “Ushtri i

Kosovës vazhdon të ketë pagë 400 euro, të ketë pajisje personale tepër joadekuatë kurse rritjen e premtuar të pagës plotë ushtarë të FSK e arrijnë përmes përmbaruesve. Premtimi i Kurtit se Kosova do të ketë ushtri të detyrueshme doli të jetë vetëm mashtrim ordiner. 'Fondi i Sigurisë' më as që përmendet nga ai. Ushtria duhet të trajtohet nga shteti me dinjitet e respekt e jo me mashtrim. Ushtria nuk është dhe s'do të duhej kurrë të ishte kazan i votave të Albin Kurtit”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

## Shefi i AKI-së dhe ai CIA-s zbuluan pllakën e mirënjohjes ndaj ShBA-së

PRISHTINË, 4 SHTATOR - “Asgjë nuk mund të bëjë më krenar sesa shërbimi me nder ndaj vendit tënd!”. Ky ishte mesazhi që oficeri ushtarak amerikan Joseph Burns i kishte dhënë të birit të tij William Burns, mesazh ky që tani qëndron i gdhendur në një pllakë simbolike në objektin qendror të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI). Kështu është bërë me dije në një njoftim të lëshuar nga AKI-ja. Ceremonia e zbulimit të kësaj pllake u mbajt më 22 gusht 2024. “Në një ceremoni të mbajtur më 22 gusht 2024, drejtori i AKI-së, Petrit Ajeti, së bashku me drejtorin e CIA-s, William Burns, zbuluan këtë pllakë si shenjë mirënjohjeje të përhershme ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, CIA-s dhe personalisht z. Burns”,

thuhet në njoftim. Pllaka, përveç këtij mesazhi të fuqishëm, mban edhe emblemat e dy agjencive, duke simbolizuar lidhjen e fortë mes dy institucioneve. E drejtori i Institutit Octopuc, Agim Musliu, ka deklaruar se kjo pllakë është një nderim për drejtorin e CIA-s, William Burns. “Kjo pllakë graniti e prezantuar nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës (AKI) është një nderim për drejtorin e CIA-s, William Burns, duke njohur rolin e tij të jashtëzakonshëm si aleati ynë më i madh. Dedikimi është realizuar me profesionalizëm të lartë dhe premtim një të ardhme të ndritur për bashkëpunimin tonë. Fotot tregojnë qartë cilësinë dhe rëndësinë e këtij nderimi”, ka shkruar Musliu në “X”.



## Hidhet mjet shpërthyes në oborrin e një shtëpie në Zubin Potok

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Policia e Kosovës ka konfirmuar se në orët e hershme të së mërkurës është hedhur një mjet shpërthyes në oborrin e një shtëpie të banuar me serbë në Zubin Potok. Zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës për veriun, Veton Elshani, ka thënë se dyshimet ekzistojnë që bëhet fjalë për granatë dore. “Ka pasur dëme materiale në vetura dhe në dritaren e

shtëpisë”, ka thënë ai, duke treguar se Policia ka nisur hetimet për këtë rast. Elshani nuk ka bërë me dije nëse ka pasur pasoja në njerëz. Një rast si ky nuk është i rrallë në veriun e Kosovës në vitet e fundit. Për hedhje të mjeteve shpërthyes dhe djegie të veturave është raportuar disa herë në këtë rajon, sidomos në kohën e reregjistrimit të

makinae me targa ilegale serbe në ato RKS - Republika e Kosovës. Zubin Potoku, bashkë me Mitrovicën e Veriut, Zveçanin dhe Leposaviqin, janë katër komunat me shumicë serbe në veri. Tensionet në atë pjesë kanë qenë relativisht të larta në muajt e fundit për shkak të atyre që qeveria i konsideron si hapa për shtirje të sovranitetit në atë pjesë.





# Vendimi për pagën minimale ngre dilema ligjore, Ministria e Financave hesht

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Vendimi i Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagës minimale mund të konsiderohet i paligjshëm, pasi ajo nuk i ka respektuar ligjet e miratuara në Kuvendin e Kosovës, thotë Naim Jakaj, hulumtues në Institutin e Kosovës për Drejtësi.

Ligjet e përcaktojnë qartë se kush e propozon pagën minimale, thotë Lulzim Rafuna, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës. “Se a janë shkelur ato, është organ tjetër që vendos. Ligjet janë të qarta”, sipas tij.

Bëhet fjalë për Ligjin për Këshillin Ekonomiko-Social, Ligjin e Punës dhe Ligjin e Pagave. Sipas këtyre ligjeve, vendimi për rritjen e pagës minimale duhet të bëhet në fund të çdo viti kalendarik me propozim të Këshillit Ekonomiko-Social (KES), ose pasi Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Kosovës (MFPT) e informon Këshillin për një propozim të ri në Qeverinë e Kosovës.

Këshilli Ekonomiko-Social përbëhet nga pesë përfaqësues të punëtorëve (sindikatave), pesë përfaqësues të punëdhënësve (odat ekonomike) dhe pesë zyrtarë që caktohen nga qeveria.

Më 28 gusht Qeveria e Kosovës ka marrë vendim ta rrisë pagën minimale në 350 euro për punëtorët e sektorit publik dhe privat të të gjitha moshave.

Vendimi, i cili është marrë vetëm pak ditë pas hyrjes në fuqi të një ligji të ri për pagën minimale, pritet të fuqizohet më 1 tetor.

Deri më tash punëtorët me pagë minimale në Kosovë kanë marrë 130 deri në 170 euro në muaj.

Në kontinentin evropian Kosova e ka pagën më të vogël minimale, ndërsa Luksemburgu i prin listës si shteti me pagën më të madhe minimale. Paga minimale e një shteti përcaktohet me ligj dhe zbatohet për shumicën e punonjësve të atij shteti.



## Çfarë thonë palët në KES?

Atdhe Hykolli, udhëheqës i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, thotë se ky mekanizëm nuk ka bërë ndonjë propozim për pagën minimale. Sipas tij, as ministri i Financave, para propozimit të vlerës së saj në qeveri, nuk është konsultuar apo nuk e ka informuar atë. Ngjashëm pohon edhe Rafuna. “Nëse është shmangur kjo procedurë, vendimi i qeverisë mund të konsiderohet i paligjshëm, pasi ajo nuk e ka respektuar ligjin që vetë e ka propozuar dhe që Kuvendi e ka miratuar”, thotë Jakaj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, i cili, mes të tjerash, monitoron zbatimin e ligjeve në vend.

Me gjithë pyetjet e disahershme të REL-it në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve se a është konsultuar me Këshillin Ekonomiko-Social dhe a e ka informuar atë për rritjen e pagës minimale, ky institucion nuk është përgjigjur.

Për Visar Ymerin, drejtor i Institutit për Politika Sociale në

Prishtinë “Musine Kokalari”, mënyra se si është marrë vendimi për rritjen e pagës minimale është “arbitrarë”. Sipas tij, qeveria po mundohet ta përjashtojë dialogun social. “Mesa kam parë unë, qeveria nuk ka kurrfarë shpjegimi përse paga minimale është bërë 350 euro, pse jo 400, 500, 200... Ky arbitraritet i qeverisë bën dy dëme njëkohësisht. Në njërin anë bën shkelje ligjore, duke i përjashtuar përfaqësuesit e punëtorëve dhe bizneseve nga dialogu social dhe, në anën tjetër, ne nuk dimë se sa është e mjaftueshme kjo pagë”, thotë Ymeri për “Radion Evropa e Lirë”.

## Çfarë thonë ligjet?

Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Këshillin Ekonomiko-Social (KES) në vitin 2011 - një vit pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Punës.

Në bazë të Ligjit të Punës, Qeveria e Kosovës në fund të çdo viti kalendarik e përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social dhe më pas ajo vendoset nga qeveria, sipas

kritereve të caktuara.

Në Ligjin për Këshillin Ekonomiko-Social thuhet, po ashtu, se Ministria e Financave duhet të shpallë ftesë publike për konkurs për përfaqësimin në këtë mekanizëm për organizatat e të punësuarve dhe punëdhënësve.

Hykolli thotë se ky këshill nuk funksionon që nga viti i kaluar, pasi mandati katërvjeçar i anëtarëve të tij ka skaduar dhe se konstituimin e tij duhet ta bëjë Ministria e Financave.

Kjo e fundit nuk i është përgjigjur pyetjes së REL-it as në lidhje me konstituimin e këtij këshilli.

## Ndryshimet në ligj

Vendimi për rritjen e pagës minimale në 350 euro është bërë vetëm pesë ditë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pagën Minimale, në bazë të të cilit vlera e saj ishte 264 euro.

Në atë ligj, që përcakton shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore me të ardhura personale vjetore, thuhet se qeveria, në fund të çdo viti

kalendarik, e përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social.

Por, në ndryshimin që është bërë në ligj, thuhet se “në mungesë të një propozimi të tillë, Ministria për Financa, pas informimit të Këshillit Ekonomiko-Social, mund të parashtrijë një propozim të tillë për Qeverinë e Republikës së Kosovës”.

Rafuna thotë se as këtë ndryshim në ligj ministria në fjalë nuk e ka respektuar. “Do të thotë, nuk e ka dërguar asnjë informatë. Së paku të njofonte se po propozon pagë minimale në qeveri. Është totalisht mungesë e dialogut social dhe e transparencës”, thotë Rafuna.

Jakaj thotë se Këshilli Ekonomiko-Social nuk mund të trajtohet si joekzistent. “Në rastin konkret, vendimi mund të kontestohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative nga ana e Avokatit të Popullit, shoqatave sindikale apo organizatave të tjera”, thotë Jakaj.

Padia, sipas tij, mund të iniciohet brenda afatit prej 30 ditësh që nga data e publikimit të aktit administrativ përfundimtar.

Për mundësinë e ngritjes së ndonjë padie, “Radio Evropa e Lirë” pyeti Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Odën Ekonomike të Kosovës, por asnjëra palë nuk u përgjigj, duke thënë se ato janë të interesuara fillimisht për konsolidimin e Këshillit Ekonomiko-Social.

Duke iu përgjigjur me shkrim pyetjes së njëjtë të “REL”-it, Avokati i Popullit tha se vendimet e qeverisë mund të sfidohen me procedura gjyqësore, “por në rastin konkret nuk mund të konstatojmë pa një vlerësim se a ka hapësirë për inicim të padisë”.

Përndryshe, vlera e pagës minimale në Kosovë nuk ka ndryshuar qysh në vitin 2011 dhe ajo ka mbetur më e ulëta në Evropë.

## Rizvanolli në Forumin Strategjik të Bledit diskuton për zhvillimin në fushën e energjisë

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, gjatë pjesëmarrjes së saj në Forumin Strategjik të Bledit, është takuar me ministrin sloven të Mjedisit, Klimës dhe Energjisë, Bojan Kumer, dhe atë të Ekonomisë, Turizmit dhe Sportit, Matjaz Han. Gjatë takimit të ministres Rizvanolli me ministrin Kumer u diskutua për zhvillimin në fushën e energjisë, për rritjen e investimeve dhe kapaciteteve

të reja të energjisë së gjelbër, në veçanti për projektet e energjisë nga era.

Ndërsa në takimin që ka zhvilluar me ministrin Han u diskutua për rritjen e investimeve të huaja direkte në Kosovë, bashkëpunimin e ndërsjellë në mes të kompanive të Kosovës dhe slovene, ku ministria Rizvanolli e njoftoi për progresin që ka shënuar Kosova në zhvillimin ekonomik.

Po ashtu, ministria Rizvanolli theksoi se për të dytën herë sivjet në Slloveni mikpritja ishte e ngrohtë dhe diskutimet produktive, ndërsa u shpreh se mezi pret që t'i mirëpresim në Kosovë, me shpresë që kjo do të jetë në kuadër të një forumi ekonomik të përbashkët.

Dy ministrat slovenë shprehën gatishmërinë dhe vullnetin për ta thelluar edhe më tej bashkëpunimin ekonomik me Kosovën.





# Lufta për grurin (dhe kush po përfiton)



Të veshur me uniforma të bardha, admiralët në komandë të flotës ushtarake turke, bullgare dhe rumune njoftuan në 1 korrikun e kaluar nisjen e operacioneve MCM në Detin e Zi, një grup pune i përbashkët që do të mbikëqyrë operacionet e pastrimit të minave. Gjatë fazave fillestare të pushtimit të Ukrainës, në fakt, forcat ruse kishin mbushur ujërat e brigjeve armike me mina. Megjithatë, disa mina janë zhvendosur me kalimin e kohës, duke e bërë të rrezikshëm lundrimin në basen. Edhe pse nuk është objektivi i deklaruar, aktiviteti do të shërbejë gjithashtu dhe mbi të gjitha për lehtësimin e korridorit të ri ukrainas të grurit. Pasi një vit më parë Moska u tërhoq nga marrëveshja që i kishte lejuar Kievit të eksportonte prodhimin e konsiderueshëm të drithërave nga deti (në vitin 2024 do të jenë rreth 50 milionë tonë, nga të cilët rreth njëzet janë grurë), qeveria e Volodymyr Zelenskyy doli me një zgjidhje alternative. Ajo ka krijuar një rrugë të re, e cila nga porti i Odesës prek brigjet lindore të Detit të Zi, duke kaluar ujërat territoriale të sigurta të fqinjëve, jashtë rrezes së raketave ruse, deri në ngushticën e Dardaneleve, nga e cila më pas ngarkesat shpërndahen drejt destinacioneve të tyre në të gjithë botën. Një marifet që i ka lejuar Ukrainës, e konsideruar si një hambar i botës, të kthehet në eksportimin e vëllimeve të konsiderueshme të fruteve të tokës së saj: para konfliktit, në fakt, vetëm ajo mbulonte një të dhjetën e nevojave të botës për grurë, misër, elb dhe fara luledielli. Në shkurt, falë rrugës alternative, më shumë se pesë milionë tonë produkte

bujqësore arritën të largoheshin nga vendi: një shifër rekord në kohë lufte. Megjithatë, nuk është e sigurt që, edhe me brigjet e lira, Kiev do të jetë në gjendje të ruajë një nivel të tillë eksportesh, duke qenë se dërgesat e nisura muajt e fundit ishin mbushur me sasi të mbetura në kabanone gjatë muajve të mëparshëm. Prodhimi ukrainas në fakt duhet të përballet me humbjen e territoreve pjellore lindore dhe jugore, të korrat e të cilave tani pasurojnë Moskën, dhe me dëmin e shkakuar nga dy vjet konflikt, që vlerësimet e brendshme e vlerësojnë të paktën tetëdhjetë miliardë dollarë, midis fushave të shkatërruara nga bombat ose shumë afër linjave të armikut, infrastrukturës së shkatërruar dhe makinerive bujqësore të rrënuara. Vetëm sulmet ajrore kundër kabanoneve në portin e Odessës bënë hi 60 mijë tonë drithë, sasi kjo që do të mjaftonte për të ushqyer më shumë se një çerek milioni gojë për një vit. Pavarësisht rëndësisë së grurit ukrainas në tregjet globale, ndikimi në çmimet botërore ka qenë i përmbajtur. Pasi u ngritën në qiell në muajt e parë të luftës, duke arritur një rritje prej 30 përqind, ato gradualisht u ulën, duke shkuar drejt një rritje të përgjithshme prej dy deri në tre përqind. Tregjet qetësohen nga disponueshmëria e gjerë e burimeve alternative nga të cilat mund të sigurohen furnizimet, duke qenë se drithërat korren nga Kanada në Australi, nga Spanja në Indi. “Situata e çmimeve në tregjet e ushqimeve bazë është mjaft e qëndrueshme për momentin”, shpjegon Monika Tothova,

ekonomiste e lartë në Divizionin e Tregtisë dhe Tregjeve të FAO-s, organizata e OKB-së për ushqimin. “Ja vlen të theksohet se si rriten të korrat parësore në kontinente të ndryshme, duke krijuar rezerva në rast se, për shembull, ngjarjet ekstreme klimatike ndikojnë në prodhimin në disa zona të botës. Në një rast si ky, vende të ndryshme mund të importojnë drithëra si gruri nga vende të tjera, duke ndryshuar zonën e furnizimit”. Ndonëse të vogla, rritjet e çmimeve nuk janë aspak lajm i mirë për popullsitë më të varfëra në planet, të cilat shpenzojnë deri në tre të katërtat e pagës për t’u ushqyer, as për ata, si refugjatët nga Sudani dhe shumë zona të tjera kritike të prekura nga konfliktet dhe tensionet, që varen nga ndihma ndërkombëtare për mbijetesë. Pasoja e vazhdimtë të luftimeve në Ukrainë për çmimet e drithit vlerësohet se do të shtyjnë 23 milionë njerëz të tjerë në uri, deri në vitin 2030. Pastaj, ka nga ata që kanë mundur të përfitojnë nga situata në favor të tyre: Kina, e shtyrë nga oreksi i saj i pashtershëm për burime parësore. Pekini në fakt është bërë importuesi më i madh i ushqimit në botë, duke shpenzuar 140 miliardë dollarë çdo vit për të marrë ushqim të mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e mbi 1.4 miliardë banorëve. Dy janë shkaqet kryesore që e bëjnë prodhimin vendas të pamjaftueshëm: e para është se vendi, pavarësisht se mban një të pestën e popullsisë njerëzore, ka më pak se një të dhjetën e sipërfaqes së punësime në botë. Megjithatë, kjo përqindje është në rënie, për shkak të praktikave të paqëndrueshme bujqësore që varfërojnë tokën me lëndë

ushqyese dhe ndërtimet agresive për t’i lënë vend infrastrukturave dhe ndërtesave. Për më tepër, fermerët kinezë duhet të përballen me mungesën e ujit, e cila gjithashtu prek shumë nga rajonet e dedikuara për kultivimin e grurit. Por kërkimi i gjigantit aziatik për furnizime të reja nxitet edhe nga evolucioni i zakoneve të konsumit të banorëve të tij, të cilët janë gjithnjë e më të pasur dhe kanë nevojë të reja. Me një shtresë të mesme që tani përfshin një në dy qytetarë, kërkesa për një larmi dhe sasi më të madhe ushqimi po rritet: shembull mbi të gjitha është konsumi i mishit, i cili është trefishuar në tridhjetë vitet e fundit. Presidenti Xi Jinping e di mirë rëndësinë e ushqimit për ruajtjen e konsensusit të brendshëm, aq sa ai ka ndërhyrë personalisht për të nxjerrë direktiva mbi këtë temë dhjetëra herë në vitet e fundit. Ndër tryezat në të cilat qeveria e tij po luan për kontrollin e burimeve të rëndësishme ushqimore, është edhe loja ruso-ukrainase. Gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi marrëveshja për “korridorin e parë të grurit”, Kina porositi sasi të mëdha gruri ukrainas, të blerë natyrisht me një çmim të zbritur për shkak të rreziqeve më të mëdha të sigurisë. Një propozim që qeveria e Volodymyr Zelensky, edhe pse kuptohet jo entuziaste për të pasur si klient partnerin kryesor strategjik të pushtuesit rus, nuk ishte në gjendje ta refuzonte pasi kish bërë llogaritë. Megjithatë, lideri kinez nuk e ka harruar mikun e tij nga Kremli dhe në vitin 2022 përuroi Korridorin e tij New Land Grain, terminali i parë hekurudhor në botë i specializuar për transportin e drithërave, që lidh Kinën me

shtetet e Bashkimit Ekonomik Euroaziatik, përkatësisht Armenia, Bjellorusia, Kazakistani, Kirgistani dhe mbi të gjitha Rusia, duke rritur importet e drithërave nga kjo e fundit me 78 përqind. Përveç kësaj, falë infrastrukturës së re, e cila do të lëvizë 22 mijë kontejnerë në të njëjtën kohë, tetorin e kaluar Xi Jinping dhe Vladimir Putin nënshkruan një marrëveshje mbresëlënëse, sipas së cilës fuqia euroaziatike merr përsipër t’i shesë kompanive të “fqinjët të pangopur”, 70 milionë tonë vaj të drithërave dhe farave gjatë dymbëdhjetë viteve të ardhshme, për një vlerë prej mbi 25 miliardë dollarësh. Është një pakt që ka dobi gjeopolitike dhe ekonomike: Moska mund të zvogëlojë ndikimin e sanksioneve perëndimore në eksportet e saj bujqësore dhe potencialisht të arrijë tregje të reja në Azinë Lindore. Pekini mund të diversifikojë më tej burimet e furnizimit, duke u mbrojtur nga një embargo e mundshme tregtare e SHBA-së dhe ndërprerjet në zinxhirin e furnizimit, si ato që ndodhën muajt e fundit në Detin e Kuq, me sulmet e milicëve Houthis mbi anijet, ngarkesat perëndimore dhe në Panama, ku thatësira ka ulur kapacitetin e tranzitit në kanal. Me pak fjalë, për presidentin kinez, siguria ushqimore e vendit është një çështje strategjike dhe jo vetëm politike. Siç dihet, në librin Arti i Luftës, strategu legjendar kinez Sun Tzu shkruante: “Një ushtri pa drithë dhe ushqim është e humbur”. Dhe mund të vihet bast se Dragoi, në betejën e tij për epërsi globale, nuk ka ndërmend të mposhtet nga një sulm urie.

bota.al





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Prishtina huazon dy futbollistë, transferon Yakubun

Prishtinë, 4 shtator - FC Prishtina ka njoftuar të mërkurën se ka huazuar dy futbollistë në skuadrat e tjera. Fjala është për Naxhi Berishën dhe Timitope Fadahunsi, derisa

klubi kryeqytetas ka transferuar Najeeb Yakubu. “Para mbylljes së afatit kalimtar, FC Prishtina ka huazuar edhe dy futbollistë të tjerë, sulmuesin Naxhi Berisha në Flamurtar dhe sulmuesin

tjetër Timitope Fadahunsi në Rahovec. Ndërsa sulmuesi i krahut, Damuel Boimbo, për shkak të mospërfundimit të dokumentacionit, nuk ka mundur të jetë pjesë e klubit

tonë. Me kaq ende nuk ka përfunduar transferimi i futbollistëve. Skuadrës do t’i bashkohet alo e djathtë, reprezentuesi Nigerisë, Najeeb Yakubu dhe një tjetër mesfushor



krahu që është në prova”, thuhet në njoftimin e Prishtinës.

## Vojvoda dhe Hadërgjonaj: Ndeshje e vështirë, por presim tri pikë

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

Prishtinë, 4 shtator - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka zhvilluar stërvitjen e radhës në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë. “Dardanët” përballen në ndeshjen e parë të Grupit 2 në Ligën C me Rumaninë të premten nga ora 20:45. Në seancën e zhvilluar të mërkurën, përzgjedhësi Franco Foda ka vendosur fokusin kryesor në aspektin taktik, duke synuar zbatimin e ideve të tij në fushë nga ekipi për këtë përballje të rëndësishme. “Futbollistët kanë punuar me përkushtim dhe seriozitet të lartë, ndërsa pritjet janë të larta për një performancë të suksesshme”, ka njoftuar FFK-ja.

Pas stërvitjeve për ndeshjen kanë folur Florent Hadërgjonaj dhe Mërgim Vojvoda. “Kemi pasur stërvitje të mira, sidomos taktikisht. Shpresoj se jemi përgatitur mirë. Kemi marrë

informata prej trajnerit dhe stafit të tij. Jemi përgatitur deri në maksimum. E dimë se çfarë na pret dhe normalisht se do të shkojmë për fitore. Nuk kemi kaluar siç duhet në ndeshjen që kemi zhvilluar në Rumani. Kanë ndodhur disa gjëra që nuk guxojnë të ndodhin dhe normal se është një motivim shtesë se si na kanë pritur. Nuk bën të ndikojë shumë kjo, por duhet të jetë motiv që t’ia kthejmë me marrjen e tri pikëve”, ka thënë Hadërgjonaj. “Mesazhi për ‘Dardanët’? E di se janë shitur të gjitha biletat dhe kjo na jep zemër neve si gjithmonë kur luajmë në ‘Fadil Vokrri’. Shpresoj të na motivojnë, por kryesorja është që ne ta bëjmë lojën në fushë dhe t’i marrim ata mbase vetes që edhe ata ta japin kontributin e tyre”, ka shtuar Hadërgjonaj.

Edhe Mërgim Vojvoda është optimist për ndeshjen ndaj rumunëve, e cila është e para për këtë edicion në Ligën e Kombeve. Mbrotjtësi i Torinos beson se



Kosova do të arrijë fitore në këtë ndeshje. “Atmosfera është shumë e mirë. Çdo lojtar është duke u ndier mirë. Jemi të gjithë në formë të mirë dhe presim të kemi një lojë të mirë. Edhe pse kundërshtari është një prej rivalëve më të fortë, ne do të

hyjmë në fushë për t’i marrë tri pikë. Presim fitore. Besoj se këtu në ‘Fadil Vokrri’ duhet të presim vetëm fitore para tifozëve tanë”, ka thënë Vojvoda, i cili pati edhe një mesazh për tifozët “dardanë”: “Na kanë munguar shumë. Shpresojmë që stadiumi të jetë i

mbushur dhe i zjarrtë siç ka qenë gjithmonë sepse kemi nevojë për lojtarin e 12-të”. Stërvitja e fundit para ndeshjes me Rumaninë zhvillohet sot (e enjte) nga ora 17:30, por paraprakisht nga ora 17:00 do të mbahet konferenca për medie.

## Shpërblim financiar për medalistët, Rama: Do ta mbështesim sportin

Tiranë, 4 shtator - Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, në ceremoninë e pritjes për medalistët në Lojërat Olimpike, u shpreh se qeveria do të vijoje t’i mbështesë federatat dhe planet që synojnë përmirësimin e kushteve për të gjitha ata që synojnë t’i futen rrugës së sportit. Ai theksoi se Shqipëria është në rrugën e duhur dhe këtë vizion të gjithë bashkë duhet ta çojmë përpara. “Ata janë të barabartë në Shqipëri, njësoj si ata që kanë lindur në Shqipëri dhe patjetër nuk na ndalon askush që të jemi



krenarë për medaljet e tyre, por janë medalje të shumta në boks, janë medalje të shumta edhe në

turne ndërkombëtarë të sporteve të tjera për të cilat nuk po zgjatëm, por po them vetëm

kaq, që të ndërtohet sportistë që arrijnë të ngjiten në një nivel e të konkurrojnë me dinjitet. Jemi në rrugën e duhur dhe hap pas hapi do të ndërtojmë një sistem sporti dhe një botë sportive shqiptare që do të jetë dinjitoze, që t’u japë mundësi fëmijëve. Do ta mbështesim me të gjithë mundësitë tona planin e Fidelit. Unë besoj që edhe Fideli vetë nuk e mohon dot, se qeveri si kjo për sportin, nuk ka pasur sporti më parë dhe nuk ka si ta gjejë më pas, sepse minimalisht duhet të kesh një vizion, ne e kemi. Pasioni për sportin nuk na

mungon, por edhe kur na mungon, e kemi Fidelin që e kemi si doping natyral dhe duhet patjetër mbështetje. Të gjitha këto, besoj, i kemi për t’i vënë në dispozicion të federatave dhe sporteve”, ka thënë Rama. Në ligjin e ri të sportit të miratuar në vitin 2021, sportistët medalistë me medalje bronz shpërblehen me 5 milionë lekë të reja dhe do ta marrin dhe gradën kolonel në Ushtrinë Shqiptare. Çeku me vlerën financiare u nda nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ogerta Manastirliu.

## Sot tërhiqet shorti për edicionin e ri në Superligë

Prishtinë, 4 shtator - Sot (e enjte) nga ora 11:00 do të tërhiqet shorti për edicionin e ri në Superligën e meshkujve në basketboll. Shorti do të

hidhet në prani të përfaqësuesve të klubeve të elitës. “Ky edicion pritet të jetë edhe më interesant, duke marrë parasysh përfundimet e

skuadrave të elitës. Edicioni i ri fillon më 14 shtator, kurse për herë të parë, ndeshjet finale të ‘play-off’-it, do të zhvillohen me katër fitore, ku pritet garë

shumë e ‘nxehtë’ për titullin e kampionit”, thuhet në njoftimin e FBK-së. KB Trepça është kampione në fuqi.





## Babë e bir në një ekip në NBA

Los Anxhelos, 4 shtator - Një ëndërr e dyfishtë u realizua. LeBron James do të luajë në krah të të birit në basketbollin amerikan, pasi Bronny James u zgjodh për të qenë pjesë e NBA-s, me 19-vjeçarin që do ta veshë fanellën e Los Angeles Lakers, njërit prej dy klubeve më të mëdhenj në rruzull, e do të jetë bashkë me

të atin. Një kontrast i madh ky, pasi mes dy basketbollistevë që i përkasin të njëjtës familje ka një diferencë moshe 20-vjeçare, me "Mbretin", LeBron James, i cili është 39 vjeç, e në dhjetor të këtij viti mbush 40, teksa mund të konsiderohet edhe si legjenda e madhe dhe e gjallë e basketbollit amerikan dhe atij botëror.

Gjatë 20 vjetëve karrierë ka fituar 4 tituj, ka thyer rekordin e pikëve dhe është lojtari më i kompletuar në histori, në të gjithë elementët si pikët, topat në tabela e asistimet. Nuk dihet nëse do të cilësohet më i madh sesa Michael Jordan, i barabartë apo pak më poshtë se ai, gjithsesi, dëshira e tij e madhe vitet e fundit ishte të

vazhdonte aq sa të luante me të birin. Sidoqoftë, nuk dihet nëse kjo dyshe, "babë e bir", do të ketë sukses në parket. Nëse si biznes është i shkëlqyer, Bronny James ka marrë kritika për nivelin e tij të basketbollit, madje këto janë shtuar kohët e fundit e, për më tepër, ai pati edhe operacion në zemër, ndërsa



vazhdonte në basketbollin e kolegjeve.

# Seferi dhe Hoxha: Duam vendin e parë në grup



Tiranë, 4 shtator - Kombëtarja shqiptare nisi zyrtarisht ditën e hënë përgatitjet për dy ndeshjet ndaj Ukrainës (7 shtator, "Epet Arena") dhe Gjeorgjisë (10 shtator, "Air Albania"), të vlefshme për edicionin e ri të Ligës së Kombeve. Në kuadër të këtyre dy sfidave të rëndësishme për kuqezinjtë, sulmuesi Taulant Seferi dhe mesfushori Arbër Hoxha dhanë prononcimet e tyre për "Fshf.org", duke treguar objektivat e Shqipërisë në këtë kompeticion dhe se si po shkojnë përgatitjet e Kombëtares. Arbër Hoxha u shpreh se skuadra po përgatitet maksimalisht për të marrë rezultate pozitive në këto dy ndeshje të para të Shqipërisë në Ligën e Kombeve. Mesfushori kuqezi vlerëson dy kundërshtarët, ndërsa tregon objektivat e kombëtares në këtë edicion të ri të Ligës së Kombeve, që është vendi i parë në grup. Ndër të tjera, Hoxha u bënë thirrje tifozëve shqiptarë të jenë të pranishëm në stadiumin "Air Albania" në ndeshjen kundër Gjeorgjisë më 10 shtator. "Së pari dua të fokusohemi te ndeshja e parë me Ukrainën që e kemi më 7 shtator. Është një kundërshtar i fortë, ka lojtarë shumë cilësorë në

radhët e veta. Kemi edhe disa ditë për ta përgatitur ndeshjen dhe të fokusohemi 100 % që të arrijmë një rezultat pozitiv në këtë ndeshje. Sfidat me Gjeorgjinë në 'Air Albania' është një ndjenjë e madhe sepse është ndeshja ime e parë në stadiumin 'Air Albania'. U bëj thirrje shqiptarëve që të jenë sa më të shumtë dhe ta mbushin stadiumin", ka thënë Hoxha. Lidhur me objektivin e Shqipërisë në Ligën e Kombeve, Hoxha ka deklaruar: "Duke marrë parasysh që është një mundësi shumë e mirë për Botërorin, pse mos të renditemi në vendin e parë. Kemi skuadra shumë të forta në grup, por ne do ta japim maksimumin gjithmonë për Kombëtaren tonë". Taulant Seferi tregon se përgatitjet për dy ndeshjet e para në Ligën e Kombeve po shkojnë shumë mirë dhe shton se për momentin fokusi kryesor është te takimi në transfertë ndaj Ukrainës. "Kemi nisur grumbullimin dhe kemi dy ndeshje. Ukraina dhe Gjeorgjia janë dy kundërshtarë shumë të fortë. Kemi filluar përgatitjet për ndeshjen e parë ndaj Ukrainës dhe po shkojnë shumë mirë. Kemi edhe disa ditë për të marrë

më shumë informacion për ekipin kundërshtar dhe duhet të futemi në fushë për ta dhënë maksimumin. Të gjithë e dimë se Ukraina është një kombëtare fizike shumë e fortë dhe duhet të përgatitemi në maksimum. E njoh kampionatin e Ukrainës dhe disa lojtarë që luajnë atje, janë një kombëtare shumë fizike pasi atë stil loje kanë. Janë kundërshtarë shumë të fortë dhe duhet të përgatitemi mirë për ta dhënë maksimumin", ka thënë sulmuesi kuqezi, i cili shton se objektivi kryesor është për ta nisur me fitore ndaj Ukrainës. "Objektivi kryesor yni është që në çdo ndeshje ta japim maksimumin dhe shpresojmë që në ndeshjen e parë të dalim fitimtarë, pastaj t'i nisim përgatitjet për ndeshjen me Gjeorgjinë", ka deklaruar Seferi, i cili në fund ka edhe një thirrje për tifozët për ndeshjen ndaj Gjeorgjisë në "Air Albania". "Ndeshjen në 'Air Albania' mezi po e presim pasi kemi disa muaj që nuk kemi luajtur në Tiranë. U bëj thirrje tifozëve pasi asnjëherë nuk kanë munguar dhe e di që do të vijnë shumë, por shpresoj që stadiumi të jetë 'full' edhe në këtë ndeshje", ka deklaruar Seferi.

## SHKURT

### Chelsea interesohet për Zhegrovën

Edon Zhegrova mund të transferohet në Premierë Ligë, pasi Chelsea ka shprehur interesim për transferimin e reprezentuesit në afatin kalimtar të ardhshëm, raporton "Fichajes". Zhegrova është pjesë e Lille nga viti 2022, kurse ka luajtur edhe për Genk dhe Basel. Futbollisti "dardan" ka bërë përparim të dukshëm si lojtar dhe është një nga talentet që ka zgjuar interesimin e shumë klubeve të mëdha evropiane. Në ndeshjen e fundit të kampionatit francez, Zhegrova shënoi gol në ndeshjen që Lille e humbi nga PSG-ja (2-1).

### Reali synon transferimin e Rodrit

Real Madridi nuk ka ndër mend të ndalet, me presidentin Florentino Perez që planifikon një tjetër goditje të bujshme pas afrimit të Kylian Mbappes. Sipas së përditshmes spanjolle "AS": Perez ka piketuar Rodrin. Është ai objektivi i tij i ardhshëm. Rodri ka një kontratë me Manchester Cityn deri më 2027, por Perez synon ta afrojë në verën e 2025-s. Gjithnjë sipas "AS", vlera e Rodrit shkon në 130 milionë euro. Spanjollit do të ishte një goditje e fortë, nëse realizohet, një lojtar që mund të stabilizojë mesfushën e Realit pasi largimit të Kroosit, ndërsa fatin e gjermanit do të ketë shumë shpejt edhe Luka Modriq.

### Transferimi i mundshëm në Arabi, De Bruyne: Nuk kam biseduar me askënd

Mesfushori i Manchester Cityt, Kevin De Bruyne, ka deklaruar se ai nuk po ndihet i nxituar për të nënshkruar një kontratë të re apo të konsiderojë një lëvizje në Arabinë Saudite. Marrëveshja aktuale e De Bruyne do të përfundojë në qershor, por ai mbetet i qetë për situatën. "Sapo të vazhdojë sezoni jam i sigurt se do të ketë bisedime. Unë thjesht dua të ndihem mirë, të luaj futboll të mirë dhe kjo do të vijë në muajt e ardhshëm", ka thënë De Bruyne. Lidhur me thashethemet për një lëvizje të mundshme në Arabinë Saudite, De Bruyne mohoi çdo përfshirje. "Unë nuk kam folur me askënd. Ka pasur shumë zhurma dhe lajme. Unë thashë se pres një verë të qetë dhe kështu ndodhi. Kam qenë me pushime, jam kthyer, kam filluar stërvitjen. Kjo është ajo. Asgjë tjetër", ka shtuar ylli belg.

### Hummelsi arrin marrëveshje me Romën

Mbrojtësi Mats Hummels do të jetë lojtari më i ri i Romës. Siç ka bërë me dije eksperti i transferimeve Fabrizioo Romano, klubi italian dhe mbrojtësi gjerman kanë arritur marrëveshje për transferimin e tij në kryeqytetin italian. Ish-mbrojtësi i Bayern Munchenit dhe Borussia Dortmundit ka udhëtuar për në Itali për t'i përfunduar testet mjekësore. Ai do të nënshkruajë kontratë me klubin italian deri në vitin 2025, ku pritet ta marrë një pagë prej 2 milionë eurosh në sezon. 35-vjeçari është lojtari i ri që nga 1 korriku i këtij viti, pasi përfundoi kontratën me Dortmundin.

## Fluminense nderon Marcelon, stadiumi do ta mbajë emrin e brazilianit

Braziliani Marcelo është nga ata futbollistë që do të mbahet mend gjatë nga tifozët e futbollit jo vetëm për cilësitë e tij të shfaqura në tapetin e blertë, por edhe për karakterin e veçantë dhe për atë çka ai përfaqëson. Një lider i

"heshtur" në fushë, gjithmonë i buzëqeshur, anësori brazilian fitoi gjithçka çfarë një lojtar mund të fitonte në karrierën e tij, te "mbretërorët" e Real Madridit. Pasi mbylli aventurën në Madrid, ai u rikthye në shtëpi te brazilianët e

Fluminenses. Ka qenë vetë klubi që ka njoftuar se stadiumi "das Laranjeiras" do të riemërtohet, do ta marrë emrin e Marcelos, kapitenit dhe simbolit të klubit brazilian. Në të gjithë botën ka objekte të ndryshme kushtuar legjendave

të gjalla reale. Shumë të tjerë u bëjnë homazhe kampionëve të mëdhenj të së kaluarës. Do të quhet stadiumi "Marcelo Vieira" dhe ndryshimi i emrit do të zyrtarizohet me një ceremoni në nderim të kapitenit të Fluminenses, i cili u rrit në këtë

klub dhe u rikthye pas viteve të arta te Real Madridi dhe periudhës së shkurtër tek Olympicosi. Kthyer në shkurt 2023, 16 vjet pas largimit, Marcelo e udhëhoqi menjëherë Fluminensen drejt fitores në Copa Libertadores.





Rr"Motrat Qiriaz" Nr. 29, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, [www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com), [info@kolegjbiznesi.com](mailto:info@kolegjbiznesi.com)

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **17.07.2024**, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:

**SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STUDENTAVE PËR VITIN AKADEMIK 2024/2025**

**01.07.2024 deri më 30.09.2024**

| STUDIME BACHELOR                                                                                                                            | STUDIME MASTER                                                                         |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|
| 1.BANKA DHE FINANCA NË BIZNES (BA) - (3 vjeçar)<br>2.MENAXHMENT DHE EKONOMIKS (BA) - (3 vjeçar)<br>3. SHKENCA KOMPJUTERIKE (BA)- (3 vjeçar) | 1.MENAXHMENT DHE FINANCA – MA-(2 vjeçar)<br>2. MENAXHIMI I EMERGJENCAVE -MA-(2 vjeçar) |

| Dokumentat e nevojshme për Aplikim BACHELOR                                                                                                                                                                                                                                                          | Dokumentat e nevojshme për Aplikim MASTER                                                                                    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Diplomën e shkollës së mesme, (Original ose të noterizuar)<br>Certifikatën e përfundimit të shkollës së mesme, (Original ose të noterizuar)<br>Dëftesat e viteve (klasave) - I, II, III, / X, XI, XII (Original ose të noterizuar)<br>Certifikatën e lindjes,<br>Kopja e letërnjoftimit,<br>Dy foto. | Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)<br>CV<br>Certifikatën e lindjes<br>Kopjen e letërnjoftimit<br>Dy foto |

|                                                                                                                                          |                                                                                              |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------|
| <a href="http://www.kolegjbiznesi.com">www.kolegjbiznesi.com</a> ,<br><a href="mailto:info@kolegjbiznesi.com">info@kolegjbiznesi.com</a> | <b>038/045/044- 500 878</b><br><b>049/ 048- 500 – 878</b><br><b>029-230-555 : 044 131027</b> |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------|

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Reired” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810122440 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Reired” D.O.O. od Prishtinë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810122440 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Reired” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 810122440 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- “Orfinio” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr: 330465709.
- Anesa Pacolli shpall të pavlefshme dëftesën e kl. dhjetë të Gjimnazit “Ahmet Gashi” Prishtinë.
- Hysen Uka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Boris Kidriq.
- Shendrita Berisha shpall të pavlefshme dëftesën e kl. së nëntë 9të shkollës fillore “7 Shtatori”.
- Bleona Arifoviq shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme Ekonomike “Hoxhë Kadri Prishtina” Prishtinë, tri dëftesat diplomën si dhe pikët e arritshmeris.
- Bajramsha Kolukaj shpall te pavlefshme dëftesën e kl I - VIII shfmu “ Heronjtë e Lumes “ Vermice.
- Anita Burri shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Leke Dukagjini” Prizren.
- Ibrahim Muharemi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Titulli i vendit të punës:** Zyrtar për Analiza të Sistemeve të Pagesave  
**Grada e pozitës:** gjashtë (6)  
**Kohëzgjatja e punësimit:** me afat të pacaktuar  
**Departamenti:** i Infrastrukturës së Tregut dhe Pagesave  
**Divizioni:** i Analizave dhe Mbikëqyrjes së Sistemeve të Pagesave  
**Raporton tek:** Udhëheqësit të Divizionit të Analizave dhe Mbikëqyrjes së Sistemeve të Pagesave

- Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi:**
- Vlerëson, analizon dhe mbikëqyrë sistemin e pagesave si tërësi, instrumentet individuale dhe mënyrat e reja të pagesave elektronike të përdorura në kuadër të sistemit të pagesave në vend;
  - Kontribuon në hartimin e politikave, rregullave dhe procedurave/manualeve për mbikëqyrjen e sistemit të pagesave, në pajtim me standardet ndërkombëtare, me fokus parimet e BIS/CPSS për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave;
  - Realizon vlerësimin e sistemit të pagesave në pajtim me rregullat e mbikëqyrjes dhe kryen monitorimin e pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregullativën në fuqi që të sigurojë që sistemet e pagesave funksionojnë në mënyrë të sigurt, të qëndrueshme dhe efektive;
  - Vlerëson sistemin e pagesave dhe përgatit analiza të rreziqeve, përfshirë rrezikun e likuiditetit, rrezikun operacional, rrezikun kreditor, rrezikun ligjor dhe rrezikun sistematik të sistemit të pagesave;
  - Siguron që sistemet e pagesave garantojnë shkallë të lartë sigurie dhe besueshmërie operacionale, si dhe që sistemet e pagesave të kenë procedura për vazhdimësinë e punës në raste të jashtëzakonshme;
  - Kontribuon, në bashkëpunim me departamentin e licencimit, në vlerësimin e kërkesave të reja për regjistrimin dhe licencimin e institucioneve dhe operatorëve të pagesave, të kliringut dhe shlyerjes së letrave me vlerë, si dhe shërbimeve tjera të pagesave;
  - Kontribuon në rishikimin dhe plotësimin e strategjisë për zhvillimin e sistemit kombëtar të pagesave;
  - Kontribuon në përgatitjen dhe plotësimin e kërkesave/standardeve të parapara në kuadër të kërkesave për proceset integruese në BE të ndërlidhura me fushë e pagesave;
  - Realizon vlerësimin e infrastrukturës teknike dhe ligjore të pjesëmarrësve të ri në sistem;
  - Kontribuon në projektet hulumtuese që ndikojnë në zvogëlimin e parasë së gatshme në qarkullimin dhe iniciimin dhe promovimin e pagesave elektronike;
  - Udhëheqë dhe angazhohet në inspektimet e ofruesve të shërbimit e pagesave, si dhe operatorëve tjerë të mundshëm të sistemeve të pagesave;
  - Komunikon dhe koordinohet me Departamentet dhe Divizionet tjera të BQK-së lidhur me kërkesat dhe nevojat që rrjedhin, për mbarëvajtjen e mbikëqyrjes të operatoreve të pagesave individualisht dhe të sistemit në tërësi;
  - Në pajtim me standardet e BE-së, analizon mundësitë e përshtatjeve të reja në infrastrukturë teknike dhe ligjore për funksionim më efikas të sistemit të pagesave dhe rekomandon lidhur me mundësitë për ngritjen e cilësisë së shërbimeve të pagesave;
  - Ndihmon Udhëheqësin e Divizionit/Drejtorin në komunikimin dhe takimet me palët e jashtme (ofruesit e shërbimeve të pagesave, operatorët) dhe palët e brendshme (departamentet/divizionet) për çështje e përfshira në kuadër të fushëveprimit;
  - Sipas nevoje, realizon punë të tjera të lidhura me mbikëqyrjen e sistemeve dhe instrumenteve të pagesave në kuadër DSP-së, të deleguara nga mbikëqyrësi apo hierarkia më lartë apo me obligimet që rrjedhin në kuadër të përgjegjësi të përgjithshme të punës.

- Përgatitjet Profesionale/Kualifikimet:**
- Diplomë universitare në fushën e shkencave të ekonomisë, shkencave juridike, shkencave matematiko-natyrore, apo relevante;
  - Përvojë prej së paku dy (2) viteve të ndërlidhur me sistemet e pagesave dhe kornizën rregullative të fushës së pagesave, përfshirë direktivat, standardet dhe infrastrukturën për shërbimet e pagesave apo për shërbimet tjera financiare të ndërlidhura, me preferencë përvoja në sektorin bankar;
  - Shkathtësi në nxjerrjen e të dhënave statistikore dhe analizave në funksion të mbikëqyrjes së sistemeve dhe shërbimeve të pagesave;
  - Shkathtësi organizative, planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
  - Shkathtësi ndër-personale dhe të komunikimit, si dhe aftësi në zgjidhjen e problemeve dhe adaptim të shpejt me zhvillimet e reja;
  - Saktësi, vëmendje në detaje, si dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
  - Njohuri të avancuara të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
  - Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar;
  - Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

- Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**
- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
  - Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
  - Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
  - Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
  - Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
  - Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

- Procedura e aplikimit:**
- Afati i fundit për aplikim është **19 shtator 2024**.
  - Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
  - Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

**Naziv radnog mesta:** Službenik za analizu platnih sistema  
**Stepen pozicije:** šest (6)  
**Trajanje zaposlenja:** sa neodređenim rokom  
**Odeljenje:** Infrastrukture platnog tržišta  
**Odsek:** Analize i nadzora platnih sistema  
**Izveštava:** Rukovodiocu Odeljenja za analizu i nadzor platnih sistema

- Opis dužnosti i odgovornosti:**
- Ocenjuje, analizira i nadzire platni sistem u celini, pojedinačne instrumente i nove metode elektronskih plaćanja koje se koriste u platnom sistemu u zemlji;
  - Doprinosi izradi politika, pravila i procedura/priručnika za nadzor platnog sistema, u skladu sa međunarodnim standardima, sa fokusom na BIS/CPSS principe za regulisanje i nadzor platnih sistema;
  - Vrši procenu platnog sistema u skladu sa pravilima nadzora i vrši praćenje usaglašenosti sa važećim zakonima i regulativom kako bi se obezbedilo da platni sistemi funkcionišu na bezbedan, stabilan i efikasan način;
  - Procenjuje platni sistem i priprema analize rizika, uključujući rizik likvidnosti, operativni rizik, kreditni rizik, pravni rizik i sistemski rizik platnog sistema;
  - Osigurava da platni sistemi garantuju visok stepen sigurnosti i operativne pouzdanosti, kao i da platni sistemi imaju procedure za kontinuitet rada u izuzetnim slučajevima;
  - Doprinosi, u saradnji sa odeljenjem za licenciranje, u proceni novih zahteva za registraciju i licenciranje platnih institucija i operatera, kliringu i poravnanju hartija od vrednosti, kao i drugih platnih usluga;
  - Doprinosi pregledu i završetku strategije razvoja nacionalnog platnog sistema;
  - Doprinosi u pripremi i ispunjavanju zahteva/standarda predviđenih u okviru zahteva za integracione procese u EU koji se odnose na oblast plaćanja;
  - Vrši procenu tehničke i pravne infrastrukture novih učesnika u sistemu;
  - Doprinosi u istraživačkim projektima koji utiču na smanjenje gotovine u opticaju i pokretanje i promociju elektronskih plaćanja;
  - Rukovodi i angažuje se u inspekcijama pružalaca platnih usluga, kao i drugih potencijalnih operatera platnih sistema;
  - Komunicira i koordinira sa drugim odeljenjima i odsecima CBK-a u vezi sa zahtevima i potrebama koje proizilaze, za nesmetan tok nadzora platnih operatera pojedinačno i sistema u celini;
  - U skladu sa standardima EU-a analizira mogućnosti novih prilagođavanja u tehničkoj i pravnoj infrastrukturi za efikasnije funkcionisanje platnog sistema i daje preporuke u vezi sa mogućnostima za podizanje kvaliteta platnih usluga;
  - Pomaže Rukovodiocu Odseka/Direktoru odeljenja u komunikaciji i sastancima sa eksternim stranama (pružaocima platnih usluga, operaterima) i internim stranama (odeljenja/odseci) o pitanjima obuhvaćenim delokrugom;
  - Po potrebi obavlja i druge poslove u vezi sa nadzorom platnih sistema i instrumenata u okviru OPS-a, koje delegira nadzornik ili viša hijerarhija ili sa obavezama koje proizilaze iz opštih radnih odgovornosti.

- Stručna sprema/kvalifikacije:**
- Univerzitetska diploma u oblasti ekonomskih nauka, pravnih nauka, matematičko-prirodnih nauka, ili relevantnih;
  - Iskustvo od najmanje dve (2) godine u vezi sa platnim sistemima i regulatornim okvirom u oblasti plaćanja, uključujući direktive, standarde i infrastrukturu za platne usluge ili druge povezane finansijske usluge, poželjno iskustvo u bankarskom sektoru;
  - Veština izdvajanja statističkih podataka i analiza u funkciji nadzora platnih sistema i usluga;
  - Organizacione, veštine planiranja i upravljanja vremenom;
  - Interpersonalne i komunikacijske veštine, kao i veštine u rešavanju problema i brzo prilagođavanje novim dešavanjima;
  - Tačnost, pažnja na detalje i osetljivost na prioritete;
  - Napredno poznavanje korišćenja softverskih aplikacija MS Office paketa;
  - Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika u govoru i pisanju;
  - Poznavanje engleskog jezika je prednost.

- Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:**
- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
  - Propratno (motivaciono) pismo koje navodi vaše interesovanje za ovu poziciju;
  - Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrda poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije i radnog iskustva, bez ugrožavanja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka);
  - Izveštaj iz Kosovskog penzionog štednog fonda (Trusta)** za relevantni period, ili poreska potvrda od Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta ne primenjuje zakonski;
  - Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosova moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
  - Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

- Postupak apliciranja:**
- Krajnji rok za apliciranje je **19 sptembar 2024**.
  - Apliciranje se može vršiti on-line (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhiva CBK-a. Ostali oblici apliciranja neće se razmatrati.
  - Obrazac aplikacije možete preuzeti preko zvanične stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales







# TRADITË QË NGA 1992

